

BASHKIA SELENICË
KONTRATË E NËNSHKRUAR PËR DHËNIEN ME QIRA

- 1- Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor ; Bashkia Selenicë, me adresë rruga “Llambi Bombaj”, pranë spitalit Selenicë, E-mail ; bashkia.selenice@gmail.com
- 2- Lloji i procedurës së konkurimit : Ankand i hapur
- 3- Numri REF. 1A/2022 ; Loti Nr. 7
- 4- Objekti i Kontratës ; Dhënie me qira përdorimi të fondit kullosor , pronë publike e Bashkisë Selenicë , për : aktivitete turistike dhe mbarështim blegtorie për Subjektin “Shpella Vajzë ” me përfaqësues Z; Çlirim Hitaj) me Nr. NIP-ti L57102254H me adresë : Fshati Vajzë, Njësia Administrative Kotë , Bashkia Selenicë , Qarku Vlorë.
- 5- Vlera totale e kontratës është 53 000 (pesëdhjetë e tre mijë) lekë/viti pa TVSH
- 6- Data e lidhjes së kontratës : 23.08.2022
- 7- Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor : Emri ; Bashkia Selenicë me adresë rruga “Llambi Bombaj”, pranë spitalit Selenicë.

BASHKIA GRAMSH
NJOFTIM PËR “DHËNIE ME QIRA

“DHËNIE ME QIRA TË PASURISË ME EMËRTIMIN “ISH OBJEKTI I RI “ NDODHUR NË OBJEKTIN “ISH UZINA E PILAVE”, KATI PËRDHE , PASURIA ME NR.10/392, ZK 1842, NË PRONËSI TË BASHKISË GRAMSH

-Në zbatim të Vendimit nr.54, datë 05.02.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar , Udhëzimit të Ministrit nr.13, datë 26.04.2018 “Për zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.54 dt.05.02.2014, “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës e mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” i ndryshuar”, Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr. 131 ,datë 29.12.2021 “Për miratimin e dhënies me qira të objektit “objekti i ri “ndodhur në “Ish Uzina e Pilave “në pronësi të bashkisë , si dhe Ligjit Nr.139/2015 ,datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar) neni 32, dhe neni 9 pika 1.2 shkronja (a), njoftojmë :

1. Fillimin e procedurave për dhënie me qira, me konkurim të pasurisë me emërtimin “Ish Objekti i Ri “ ndodhur në objektin “Ish Uzina e Pilave”, kati përdhe , pasuria me nr.10/392, ZK 1842, në pronësi të bashkisë Gramsh, si më poshtë:
 - Sipërfaqe totale e ndërtimit = 548 m²